



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA DIBËR**

**NJESIA E PROKURIMIT**

**Data: 15.10.2025**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: REHABILITIM , SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGES SE  
VARREZAVE PILAFE 250 ML**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pune ndertimi  
(45000000-7).**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4.166.662,95**(Kater milion e njeqind e gjashtedhete e gjashtemije e  
gjashteqind e gjashtedhete e dy presje nentedhjet e pese) leke **pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78,pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor BASHKIA DIBER ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.*Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare, 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve të Nr.10091 datë 05.03.2009.), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jete jo më pak se **40 %** të vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet.

*Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore

*Shenim: Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Kjo bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

*Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**ose**

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

#### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tatimore të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

*Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

---

### **2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

N.P-1 A (Punime gjurmimi në tokë)

N.P-4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme.

N.S -6 A (Sinjalistika rrugore jo ndricuese).

N.S – 18 A (Punime topogjeodezike).

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

### **2.3.3 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

1. Inxhinier Ndertimi

1 (nje)

## 2. Inxhinier Topograf ose Gjeodet

1 (nje)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit

Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë noteriale pune.

- 1 (një) punonjes pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune, i cili të jetë i çertifikuar **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*.

*Shenim: Per kete pike 2.3.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Drejtues teknik jane kerkuar baze te punimeve qe do te kryhen per kete procedure, dhe jane ne propocion me te gjithë zerat e punimeve te preventivit.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **20 (njezet) punonjës.**

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **tre muajt e fundit**

*Shenim: Per kete pike 2.3.4. te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumnet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate dhe në baze të shpërndarjes së punimeve në të gjithë teritorin e Bashkisë Diber.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** punonjës **manovratorë** të, për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) , si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** punonjës **shoferë** , për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **1 (një)** teknik ndertimi , për të cilin duhet të paraqesë kontrate individuale pune të vlefshme, diplome, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten periudhën si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **1 (një)** betonues, për të cilin duhet të paraqesë kontrate individuale pune të vlefshme, diplome, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten periudhën si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.

Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

Specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të jenë të pajisur gjithashtu edhe me kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesen e shoqërisë për të pakten muajin e **fundit** e në vazhdim

*Shenim: Per kete pike 2.3.5 te mesiperme operatorët ekonomik në fazën e ofertimit duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr	Mjetet	Sasia	Statusi
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 8 ton	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 3.5 ton	1	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me zinxhir	1	Në pronësi ose me qera



6	Rrul ngjeshes	1	Në pronësi ose me qera
7	Nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
8	Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
9	Autobitumatriçe	1	Në pronësi ose me qera
10	Asfalto-shtrues	1	Në pronësi ose me qera
11	Fadrome me goma	1	Në pronësi ose me qera
12	Makineri vijezi	1	Në pronësi ose me qera
13	Armature	1	Në pronësi ose me qera
14	Boteniere te thjeshta	1	Në pronësi ose me qera

***Operatorët ekonomik që disponojnë kontratë furnizimi për Fabrike asfalti-betoni dhe Nyje thyerje materiale inerte, leja mjedisore u kërkojnë personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.***

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

- Kokore, minimumi 20 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 3 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë.

**a)** Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit.

**b)** Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse

noteriale të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".*

*Shenim: Per kete pike 2.3.7 te mesiperme operatorete ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga projektuesi.

**2.3.6** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit te cilesise (te vlefshme) "ose ekuivalent;

- SSH/EN/ ISO 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurise ne pune” ose ekuivalent;
- SSH/EN/ISO 39001 :2012 mbi “Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor” ose ekuivalent;

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Çertifikat e siperpermendura jane kerkuar nga ana e AK qe operoret ekonomik duhet te jene te certifikuar per cilesin e punimeve, per sigurine ne pune dhe mbi cilesine e saldimit, ku jane te lidhura ngushte me objektin qe prokurohet*

### **2.3.8. Grafiku i punimeve.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**